



ELEGJI PËR DERALLAJT

Arsim SINANI

Vite më parë më kishte rastisur të dëgjoj rrëfime të ndryshme për familjen e gjeneralit shqiptar, Mehmet Pashë Deralla. Gjithnjë më ka intriguar kjo çështje, madje që nga fëmijëria, sa herë që e shihja atë shtëpi të Derallajve në stilin gjysmë barok, në kompleksin e Spitalit të Tetovës, e cila pas Luftës së Dytë Botërore ishte nacionalizuar nga pushteti i partizanëve, për të shndërruar në fillim si spital, pastaj edhe e riparuar dhe adaptuar në një Qendër për persona me të meta mentale, që ishte një denigrim për këtë familje atdhetare dhe për pinjollët e saj. Prindërit asokohe hetonin interesimin tim për këtë shtëpi me arkitekturë karakteristike, rrallë e parë në Tetovë, por nuk më jepnin asnjë informatë më shumë se sa që mund të imagjinoja vet, nga frika se mos bëzajë gjëkund ku s'duhet në atë moshë minore.

Megjithatë kisha mësuar se kjo godinë kaq e bukur se ishte shtëpia e një familjeje shumë të çmuar shqiptare, por që nuk jetonte më aty. Kaq mund të flitej para meje për familjen Deralla. Në netët e gjata dhe të vetmisë në familjen tonë, në shtëpinë e gjyshit tim, profesorit Abdylqerim Arifi, kisha dëgjuar se ajo shtëpi prej pallati, ishte pronë e Mehmet Pashë Derallës (1843), apo e njohur në mesin e tetovarëve si Shtëpia e Halim beut (1879), të birit më të madh të Mehmet Derallës.

Gjyshi im, një ditë, kur ishim vetë, kishte vendosur të më fliste për historinë e kësaj familjeje, dhe pikërisht ky ishte momenti që më kishte inspiruar për herë të parë dhe më kishte dhënë shtytje që mos e shkëpus interesimin tim për këtë familje patriotësh dhe për padrejtësitë historike ndaj saj. Në të vërtetë, kjo familje, me shumë anëtarë, të rritur e të vegjël, gra e burra, ishte dëbuar nga Tetova dhe ishte ekstraduar në Shqipëri,

ndërsa disa sish kishin përfunduar në burg dhe internim, arratisur deri në SHBA.

Përjetime të këtilla ka pasur edhe Gajur Deralla (1909), i biri i dytë i Mehmet Pashë Derallës, i cili është burgosur dhe ka vuajtur dënimet, për t'u arratisur më në fund bashkë me familjen në Amerikë, ku edhe do të ndërrojë jetë, në përpjekjet e tij të fundit për ta organizuar diasporën shqiptare atje. Për këtë dëshmon i biri i tij, Berati, tek i cili ndonëse në moshë të thyer, vërehet zemra e madhe atdhetare e Derallajve, për të vendosur për një kthim në vendlindje, në Tetovë.

Një fat i këtillë kishte ndjekur edhe Hysen Derallën (1912), të birin e tretë të Mehmet Pashë Derallës, i cili pas burgosjeve, pa arsye ishte dëbuar bashkë me anëtarët e familjes, deri në kufi me Shqipërinë. Ishin dëbuar pa plaçka, vetëm me rrobat e trupit, për çka dëshmojnë edhe letrat dhe dokumentet që me shumë kujdes i ka ruajtur vajza e tij, Valdete Deralla, që sot mbeten pjesë të pamohueshme faktike të këtij studimi pesëvjeçar, të përgatitur dhe të realizuar me një ekip bashkëpunëtorësh në Tetovë, Tiranë, Prishtinë, diasporë e më gjerë.

Në të vërtetë, ndonëse tërheq kthimi në vendlindjen e të parëve, familja Deralla kishte humbur gjithë pasurinë dhe trashëgiminë e madhe që dispononte, pas nacionalizimit të pronave nga regjimi i atëhershëm komunist dhe kjo pasuri mbeti në duart e shtetit, edhe pas demokratizimit të vendit dhe aplikimit të Ligjit për denacionalizim, pra të kthimit të pronave. Ç'është edhe më keq, pushteti ishte kujdesur që t'i asgjësonte të gjitha dokumentet, duke i shlyer pronat nga ditarët e regjistrimit civil.

Kjo tregon se deri ku ka shkuar dora e zgjatur e pushtetit jugosllav e më vonë edhe i atij sllavomaqedonas. Me këtë dëshirohet që të fashitet nga kujtesa e një populli gjithë çka i takon një familjeje atdhetare e kombëtare, ndonëse në këto përpjekje nuk ka arritur sukses. Tentimet e familjes Derallaj për t'a kthyer pronën kanë qenë të kota, shprehet me indinjatë nipi i Halim Beut, Genc Deralla, i cili kudo që ka shkuar është prezantuar si tetovar. Por, Tetova as sot e kësaj dite nuk e ka kryer obligimin moral, që t'ua bëjë të mundur kthimin e pronës në qytetin e të parëve të tij.

Konferenca shkencore e mbajtur në dhjetor të vitit 2014 në Tetovë, për t'i kujtuar atdhetarët e familjes Deralla, gjetja dhe takimi i pasardhësve të tyre tok në këtë qytet legjendar, ishte një ngjarje e rëndësishme dhe madhore, me çka realizohen edhe disa nga synimet e kësaj Konference.

Eshtrat e gjeneralit Mehmet Pashë Deralla prehen në Teqenë Harabati Baba në Tetovë, një kompleks i bukur dhe domethënës për këtë qytet. Megjithëkëtë, mjerisht, meqë në këtë kompleks ka më shumë varre, ende nuk dihet saktësisht se cili është varri i Mehmet Pashë Derallës. Sipas dorëshkrimeve të një studimi të historianit tashmë të ndjerë, prof. dr. Ali Vishko, këtij varri i janë ndërruar gurët dhe janë ngatërruar me atë të Xheladin Beut. Këto poihome mbështeten në dokumentet e trashëguara nga raportet e Baba Qazim Bakallit, e një atdheri e patriot të cilat, fatmirësisht, profesori Ali Vishko i ka gjetur dhe mbeten si dëshmi e rëndësishme për sqarimin e dilemave. Letërkëmbimet e Baba Qazimit janë dmth për tu mbyll kjo çështje, pasi sic dihet bashkëpunimi me klerin bektashian të Teqesë së Tetovës ka qenë i ngushtë me parinë dhe patriotët e Tetovës.

Tentimet për zhvatjen e këtyre vlerave tona kombëtare, qoftë me ndërrim të gurëve varrezash, madje tash së voni edhe me përpjekjet për degradimin e këtij aktiviteti shkencor të mbajtur në shkollën amerikane "Uillson" në Tetovë, ishin të kota. Vendi meritohet historik që ka familja Deralla në tabanin kombëtar, nuk mund të rrënohet, emri i saj e mbron atë dhe është kodi i identifikimit në historinë shqiptare, që në këtë rast ky nder i takon qytetit të lindjes, Tetovës, dhe kështu do të mbetet përgjithmonë. Kam theksuar në Konferencë, por duhet të përsëritet, të mbetet e shënuar në memorien e historisë sonë kombëtare, atë të Tetovës, se ky qytet kurrë s'do të pajtohet që pasuria dhe shtëpia e Mehmet Pashë Derallës të denigrohet deri në shkallën e funksionimit për nevoja të të retarduarve mental. Dëshiroj ta mbyll këtë prolog, me premtimin se ju sjellim punime dhe hulumtime shumë interesante, të cilat do e pasurojnë historiografinë shqiptare, do e zgjojnë ndjenjën që lipset t'a kenë shqiptarët për Derallajt. Ky është vetëm fillimi. Kjo familje meriton më shumë, prandaj me kënaqësi falënderoj për bashkëpunimin institucional që kemi pasur me Universitetin e Prishtinës, Fakultetin

Filozofik dhe dekanin, prof. Bujar Dugolli, Agjencinë e Arkivave të Kosovës, me drejtorin Ramë Manaj, Muzeun Historik Kombëtar, me drejtorin Dorian Koçi dhe ish drejtorin Melsi Labin, Universitetin e Tiranës dhe rektorin prof. Dhori Kulen, Universitetin e Durrësit dhe profesoreshën e nderuar, Eva Teqja Allushi. Ndërsa një falënderim i posaçëm i shkon nikoqires së Shkollës Amerikane “Uillson” dhe zonjës Elita Masha, për mbështetjen e pa rezervë, pa të cilën nuk do bëhej ky eveniment kaq i madh i karakterit mbarëkombëtar. Poashtu e falemnderoj dr.Skender Myrtezanin dhe Shoqatën Vatra në SHBA për mbështetjen e pakursyer.

Me këtë akt po hapim një thesar, që e kemi tash jo vetëm si barrë mbi kurriz të rënduar, jo për t’a hequr qafe, përkundrazi, për t’a ngritur në vendin e duhur, në piedestalin e tabanit tonë kombëtar. Këtë punë nuk e kemi vetëm borxh, por edhe obligim kombëtar.

Ky botim nuk do ta shihte dritën e vetë pa mbështetjen e një figure poliendrike sic është veprimtari Xhevat Prespa. Po, botimi i këtij studimi është një vepër e veprimtarit Xhevat Prespa, i cili nuk hezitoi që të na mbështes për botimin mjaft cilësor për Derallajt dhe figurën e madhe të gjeneralit Mehmet Deralla dhe djemve: Halimi, Munipi, Hyseni, Gajuri, vajzat: Haxherja dhe Nixhrja. E falemnderoj për mbështetjen e tij dhe për veprimtarinë e LDSHM në SHBA duke e mbështetur çështjen shqiptare gjithëandëj.

Shpresoj në një të ardhme të shpejtë të gjej mundësinë dhe ti përkthej dokumentet nga Arkiva osmane por edhe të kem mundësi që të sjell dokumentet nga Arkivat në rajon e botë, pasi figura e Mehmet pashë Derallës meriton përkushtin dhe emri i tij të jetë aty ku e ka vendin në piedestalin e atdheut tone, Shqipërisë. Ky 175 vjetor është i veçantë sepse e festojmë lindjen e atdhetarit e themeltarit të ushtrisë shqiptare, Mehmet Pashë Deralla.